



Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit:

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024 - 2030 dhe të planit të saj të veprimit”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve:

Procesi i konsultimeve për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024 - 2030, ka zgjatur 2 muaj dhe ka përfshirë konsultime me aktorët e synuar për përcaktimin e nevojave, synimeve, prioriteteve dhe propozimeve për hartimin e strategjisë.

Konsultimet në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, ka zgjatur 21 ditë pune, në periudhën 27 mars - 26 prill 2024.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për dokumentin e draft Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024 - 2030:

1. Konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik, RENJK, për periudhën 27 mars - 26 prill 2024 (<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/716>);

2. Konsultime me aktorët e synuar dhe grupet e interesit për përcaktimin dhe vlerësimin e nevojave, synimeve, prioriteteve dhe propozimeve gjatë hartimit të dokumenteve ku përfshihen:

- Takime fizike për konsultimin me komunitetin e startup-eve dhe kompanive inovative. Në këto takime morën pjesë rreth 45 sipërmarrës nga i gjithë vendi;
- Konsultim me 20 korporata shqiptare dhe të huaja në vend;
- Takim konsultues me komunitetin e lehtësuesve me përfaqësues nga i gjithë vendi;
- Takime konsultuese me pedagogë dhe studentë të Universitetit të Elbasanit, Universitetit Europian të Tiranës dhe Universitetit Politeknik;
- Takime konsultuese fizike me 35 përfaqësuesit e partnerëve dhe institucioneve të huaja në vend, të cilët drosjnë shtyllat e sipërmarrjes dhe zhvillimin ekonomik.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e interesuara të cilat kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit janë:

- a) 45 sipërmarrës dhe themelues startup-esh nga i gjithë vendi, si Ailand, Entrenovu Albania, Marigo, Lekotech, Akademi.al, Kaktu etj.;

- b) drejtuesit e 20 korporatave të huaja dhe vëndase, si z. Christian Canacaris (Raiffeissen), z. Balazs Revesz, Vodafone, z. Diego Pisa, Teleperformance, z. Aleksander Rislia, Ritech, z. Evis Karandrea, Assist Digital etj.;
- c) 20 përfaqësues nga lehtësuesit e startup-eve shqiptare, si znj. Fabiola Duro, z. Kushtrim Shala, z. Gerti Boshnjaku etj.;
- ç) 30 përfaqësues të komunitetit të grave dhe vajzave sipërmarrëse, si znj. Erisa Sula, znj. Lindjana Xhumari, znj. Shqiponja Hatellari, znj. Sidorela Pupla, znj. Sonia Malone, znj. Rozalba Xhori etj.;
- d) 39 studentë, pedagogë dhe akademikë, si znj. Merita Toska, znj. Edlira Martiri, znj. Rudina Qurku, z. Engjell Hoxha, z. Bernard Dosti etj.;
- dh) takime konsultuese fizike me 35 përfaqësuesit e institucioneve të huaja në vend të cilët adresojnë shtyllat e sipërmarrjes dhe zhvillimin ekonomik dhe vajzave në biznes, si znj. Endrita Xhaferraj EBRD, znj. Ardiola Hristic EBRD, z. Keler Gjika, Banka Boterore, z. Bajram Korsita, ADGF, z. Michele Ribotta, UNWOMEN, znj. Sonia Kurtz, GIZ, z. Enzo Damiani, EU Delegation Tirana.

1. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar <i>(p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbliðhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Zhvillimi Infrastrukturës & Aftësive në mbështetje të sipërmarrësve	Rritja e investimeve në infrastrukturën fizike dhe virtuale duhet të vijojë në Tiranë, si dhe në disa qytete të tjera të Shqipërisë. Një nga çështjet kryesore të ngritura gjatë këtij diskutimi ishte rëndësia e një infrastrukture të fortë dhe të qëndrueshme për zhvillimin e startup-eve. Infrastrukturë e përmirësuar, si qendrat e inovacionit, inkubatorët, dhe akseleratorët, janë thelbësore për të ofruar mbështetje teknike dhe hapësira të nevojshme për rritjen e bizneseve të reja. Përfaqësuesit e startup-eve theksuan se investimi në infrastrukturë moderne do të krijonte një mjedis më të favorshëm për inovacion dhe zhvillim të qëndrueshëm. Përveç infrastrukturës fizike, diskutimi u përqendrua edhe në zhvillimin e aftësive të sipërmarrësve. Edukimi dhe trajnimi janë kyçe për të rritur kapacitetet e individëve që janë të interesuar të nisin ose të zhvillojnë bizneset e tyre. Programet e trajnimit	Themeluesit e startup-eve.	I pranuar.	Relevante për objektivat/synimet e strategjisë.

	<p>përfshirë menaxhimin e projekteve, marketingun dixhital, financat dhe teknologjitë e reja janë thelbësore për të rritur aftësitë dhe njohuritë e sipërmarrësve. Përfaqësuesit e startup-eve theksuan rëndësinë e bashkëpunimit me institucione arsimore për të zhvilluar kurrikula që i përgjigjen nevojave të tregut.</p> <p>Një tjetër pikë e rëndësishme e diskutimit ishte roli i shtetit në mbështetje të këtyre iniciativave. Shteti mund të luajë një rol të rëndësishëm në krijimin e politikave dhe rregulloreve që favorizojnë zhvillimin e startup-eve. Mbështetja financiare përmes granteve dhe subvencioneve, si dhe krijimi i një mjedisi rregullator të përshtatshëm, janë thelbësore për të nxitur inovacionin dhe rritjen ekonomike.</p> <p>Në përfundim, diskutimi nënvizoi nevojën për një qasje të integruar që kombinon zhvillimin e infrastrukturës dhe aftësive për të mbështetur sipërmarrësit dhe për të krijuar një ekosistem të qëndrueshëm dhe inovativ në Shqipëri.</p>			
Koordinimi i aktorëve.	<p>Zhvillimi i tryezave të bashkëpunimit me qëllim rritjen e koordinimit të aktorëve të nivelit qendror me njëri tjetrin për të evituar mbivendosje agjendash dhe programesh;</p> <p>Rritja e koordinimit midis aktorëve të nivelit qendror me ato të nivelit lokal për të përkthyer në masa dhe investime konkrete politikat rinore dhe politikat për të rinjtë;</p> <p>Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit me OJF-të që operojnë në Shqipëri dhe agjencitë kombëtare dhe ndërkombëtare për koordinimin e politikave rinore, orientimin e investimeve dhe përthithjen e fondeve.</p>	Lehtësuesit dhe sipërmarrësit.	I pranuar.	Relevante për objektivat/synimet e strategjisë.
Vizioni, misioni dhe parimet e strategjisë.	Duhet të ketë një qartësi në formulimin e parimeve mbi mënyrën e realizimit dhe metodologjisë që do	Korporatat.	I pranuar pjesërisht.	Relevante për objektivat/synimet e strategjisë.

	të përdoret, ku të qartësohet dhe vijimësia e implementimit të parimeve.			
Mbi zgjedhjet green dhe dixhital.	Një nga aspektet kryesore të trajtuara ishte roli i teknologjive dixhitale në transformimin e industrive tradicionale. Përfaqësuesit e startup-eve diskutuan se si teknologjitë dixhitale mund të ndihmojnë në optimizimin e proceseve të prodhimit, reduktimin e mbetjeve dhe përmirësimin e efikasitetit energjetik. Zgjidhjet dixhitale, si inteligjenca artificiale, Interneti i Gjërave (IoT) dhe analizat e të dhënave, mund të kontribuojnë në krijimin e modeleve më të qëndrueshme të biznesit dhe në përmirësimin e menaxhimit të burimeve natyrore. Gjithashtu, u dha rëndësi inovacionit të gjelbër në zhvillimin e zgjidhjeve që reduktojnë ndikimin mjedisor. Startup-et u inkurajuan të eksplorojnë mundësitë për të zhvilluar produkte dhe shërbime që promovojnë përdorimin e energjisë së rinovueshme, reduktimin e emetimeve të karbonit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve. Pjesëmarrësit theksuan nevojën për mbështetje financiare dhe rregullatore për të nxitur këto iniciativa dhe për të krijuar një ekosistem që favorizon inovacionin e gjelbër. Rekomandohet ndërthurja e disiplinave shoqërore dhe shkencore, duke krijuar klube studentore jashtëshkollore për të mundësuar ndërveprimin midis asaj çfarë ata studiojnë dhe pasioneve që ata kanë. Pjesa e përfshirjes së artit dhe kulturës në mënyrë më aktive. Rritja e kapaciteteve dhe kualifikim i vazhdueshëm i stafëve të mësuesve.	Institucionet ndërkombëtare.	I pranuar.	Relevante për objektivat/synimet e strategjisë.
Rekomandime dhe sugjerime mbi rritjen e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në sipërmarrje.	Është e nevojshme të krijojmë një mjedis mbështetës dhe inkurajues për gratë që dëshirojnë të ndërmarrin këtë rrugë. Duke marrë parasysh sfidat dhe mundësitë e ndryshme, ia disa rekomandime dhe sugjerime për të ndihmuar vajzat dhe gratë të bëhen pjesë e botës së sipërmarrjes. Një prej hapave më të rëndësishëm është investimi në edukimin e vajzave dhe grave. Krijimi i programeve	UN Women dhe komuniteti i grave dhe vajzave sipërmarrëse.	I pranuar.	Relevante për objektivat/synimet e strategjisë.

edukative të specializuara që përfshijnë lëndë mbi sipërmarrjen, menaxhimin e biznesit dhe aftësitë teknologjike është thelbësor. Për më tepër, mentorimi dhe prezantimi me *role models* të suksesshme janë faktorë të rëndësishëm që mund të frymëzojnë dhe drejtojnë gratë në rrugëtimin e tyre sipërmarrës.

Pa financim të mjaftueshëm, shumë ide të shkëlqyera mund të mbeten thjesht ide. Krijimi i fondeve dhe granteve të veçanta për gratë sipërmarrëse është një hap thelbësor për të ndihmuar në nisjen dhe zhvillimin e bizneseve të tyre. Sigurimi i shërbimeve këshillimore financiare gjithashtu mund të ndihmojë gratë të menaxhojnë më mirë burimet e tyre financiare dhe të aksesojnë financime të reja. Zhvillimi dhe implementimi i politikave që favorizojnë gratë sipërmarrëse është një domosdoshmëri. Këto mund të përfshijnë lehtësimin e aksesit në kreditë dhe përjashtimet tatimore për bizneset e drejtuara nga gratë. Një tjetër element është sigurimi i barazisë gjinore në vendin e punës dhe mbështetja e balancës midis punës dhe jetës personale për gratë.

Rrjetëzimi dhe Mbështetja Komunitare: Ndërtimi i rrjeteve mbështetëse është thelbësor. Krijimi i platformave për rrjetëzim dhe bashkëpunim midis grave sipërmarrëse mund të ndihmojë në ndarjen e përvojave dhe mbështetjen e njëra-tjetrës. Organizimi i eventeve dhe seminareve të fokusuara në zhvillimin e aftësive sipërmarrëse dhe shkëmbimin e ideve mund të ndihmojë gjithashtu.

Përmirësimi i Infrastrukturës: Qendrat e inovacionit dhe inkubatorët e biznesit janë vendet ku idetë e reja mund të zhvillohen dhe të marrin formë. Krijimi i këtyre qendrave që ofrojnë mbështetje teknike dhe burime për gratë sipërmarrëse është një hap i rëndësishëm. Përmes këtyre masave, ne mund të ndihmojmë në krijimin e një mjedisi më të favorshëm dhe mbështetës për vajzat dhe gratë që

	dëshirojnë të hyjnë në botën e sipërmarrjes. Kjo jo vetëm që do të kontribuojë në rritjen ekonomike të vendit, por edhe në përmirësimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave në të gjitha sferat e jetës.			
--	---	--	--	--